

KËRKESË
PËR SHPALLJEN TË ZHDUKUR

Kërkuese: Trëndafile Çepaj e bija e Azbiut, lindur më 1959, banuese në lagjen “24 Maji” pallati nr.1232, Vlorë.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit tim Murat Çepaj, në bazë të neneve 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Jam bashkëshortja e shtetasit Murat Çepaj, me të cilin kam lidhur martesë në vitin 1981. Nga kjo martesë kanë lindur dy djemtë tanë.

Më 30 maj 1995 bashkëshorti im u largua në drejtim të Italisë. Kanë kaluar mëse 5 vjet dhe nuk kemi asnjë njoftim për vendndodhjen e tij.

Në bazë të nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, kërkoj që Murat Çepaj të shpallet i zhdukur me vendim gjykate.

KËRKUESE
Trëndafile Çepaj